



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr.79
Prishtinë, më 21.5.2024, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204.

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Ardian Gola, kryetar, Albena Reshitaj, Enis Kervan, Arijeta Rexhepi, Jahja Kokaj, Arjeta Fejza. Adriana Matoshi, dhe Vlora Dumoshi.

Munguan: Eliza Hoxha dhe Ardian Kastrati.

Pjesëmarrës tjerë: Daulina Osmani zv ministre e ministrissë së kulturës rinisë dhe sportit, përfaqësues nga Ministria e Kulturës, mediat.

Stafi mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi: Ardian Gola, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me 14.05.2024;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-264 për Rininë;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-277 për Sport;
5. Shqyrtimi i raportit me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr.05/L-90 për Sponzorizime në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-116.
6. Të ndryshme.

Kryetari, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 14.5.2024

Procesverbali i mbledhjes së mbajtura më 14.5.2024, miratua pa vërejtje.

3.Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-264 për Rininë

Ardian Gola, kryetar, tha se Grupi punues ka bërë shqyrtimin e Projektligjit nr.08/L-264 për Rininë, gjithashtu lidhur me këtë Projektligj janë mbajtur disa Dëgjime Publike nëpër komunitet e Kosovës.

Arieta Fejza si kryesuese e Grupt punues tha se ky projektligj është i rëndësishëm së veçantë dhe është shqyrtuar me akterët tjerë relevantë në bashkëpunim me OSBE – në. Grupi punues ka paraparë gjithsejt trembëdhjetë dy (13) amendamente për këtë projektligj si vijon :

Amandamenti 1

Neni 3, nënparagrafi 1.13 ndryshohet si në vijim:

1.13. Organizatë rinore - organizatë joqeveritare, jofitimprurëse, e regjistruar sipas legjislacionit në fuqi, në të cilën së paku $\frac{2}{3}$ e anëtarëve janë të moshës rinore;

Neni 3, nënparagrafi 1.14 ndryshohet si në vijim:

1.14. Organizatë për të rinjtë - organizatë joqeveritare, jofitimprurëse, e regjistruar sipas legjislacionit në fuqi, që në fushëveprimin dhe statutin e saj ka referencë sektorin e rinisë dhe u shërben të rinjve;

Amandamenti 2

Neni 6, paragrafi 2, ndryshohet si në vijim:

2. Komisioni themelohet me vendim të Qeverisë, udhëhiqet nga kryeministri/ja dhe përbëhet nga ministrinë në nivel të ministrave.

Neni 6, pas paragrafit 2, shtohet paragraf i ri me këtë përmbajtje:

3. Përfaqësuesi i Këshillit Qendror Rinor merr pjesë në takimet e Komisionit me rol këshillues, avokues dhe monitorues.

Paragrafët tjerë renditen sipas radhës.

Amandamenti 3

Neni 7, nënparagrafi 2.5, ndryshohet si në vijim:

2.5. arsim, inovacion dhe edukim joformal;

Neni 7, nënparagrafi 2.11, ndryshohet si në vijim:

2.11. të drejtat e njeriut dhe komuniteteve.

Neni 7, nënparagrafi 3.1, ndryshohet si në vijim:

3.1. hartimi, miratimi dhe zbatimi i dokumenteve strategjike, politikave sektoriale rinore, akteve ligjore dhe nënligjore të fushës së tyre që kontribuojnë në zhvillimin e rinisë;

Amandamenti 4

Neni 8, paragrafi 1, ndryshohet si në vijim:

1.Ministria përkatëse për rini është përgjegjëse për hartimin e legjislacionit, politikave në fushën e rinisë dhe ofrimin e hapësirave për zhvillimin e aktiviteteve të rinjve në fushat kulturore, rinore, rekreative dhe sportive në koordinim me Agjencinë, institucionet publike qendrore dhe lokale dhe Këshillin Qendror.

Neni 8, nënparagrafi 2.1, ndryshohet si në vijim:

2.1. hartimi dhe zbatimi i legjislacionit në fushën e rinisë dhe propozimi i ndryshim/plotësimeve të ligjeve dhe akteve nënligjore që kanë ndikim në rininë;

Amendamenti 5

Neni 11, nënparagrafi 1.3, ndryshohet si në vijim:

1.3.bashkëpunimi me institucionet publike qendrore dhe lokale dhe mbështetja për sigurimin e zbatimit të dispozitave të legjislacionit në fushën e rinisë;

Amendamenti 6

Neni 12, ndryshohet dhe bartet pas nenit 22 të këtij projektligji:

Neni 12

Financimi

1. Mjetet financiare për zbatimin e këtij ligji sigurohen nga buxheti i Republikës së Kosovës, të hyrat vetanake, sponsorizimet e donacionet dhe financimet tjera alternative në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Të hyrat vetanake që krijohen nga ky ligj derdhen në buxhetin e shtetit dhe ndahen sipas legjislacionit në fuqi.

Amendamenti 7

Neni 13, paragrafi 1, ndryshohet si në vijim:

1.Përgjegjësitë e institucioneve publike lokale, përfshirë drejtorive komunale të rinisë, janë:

Neni 13, nënparagrafi 1.2, ndryshohet si në vijim:

1.2. sigurimi i resurseve njerëzore në komunat përkatëse, përfshirë caktimin e së paku një zyrtari/eje rinor/e, me kapacitete profesionale për: identifikimin, koordinimin, bashkëpunimin, monitorimin dhe zbatimin e politikave rinore në komunat përkatëse;

Amendamenti 8

Neni 15, paragrafi 1, ndryshohet si në vijim:

1. Këshilli Qendror Rinor është grup këshillues, avokues dhe monitorues për çështjet rinore, i cili shërben si platformë për bashkëpunimin ndërmjet Qeverisë, Këshillave Lokalë, organizatave rinore, organizatave për të rinjtë dhe grupeve joformale.

Neni 15, paragrafi 6, ndryshohet si në vijim:

6.Agjencia dërgon njoftimin për përbërjen e Këshillit Qendror të ministri/ja. Këshilli Qendror njihet nga ministri/ja me mandat trevjeçar (3).

Neni 15, paragrafi 9, ndryshohet si në vijim:

9. Procedurat e themelimit, organizimit dhe funksionimit të Këshillit Qendror Rinor rregullohen me akt nënligjor nga ministria përkatëse për rini dhe aktet normative të Këshillit.

Amendamenti 9

Neni 16, paragrafi 1, ndryshohet si në vijim:

1. Këshillat Lokalë Rinorë janë grupe këshilluese, avokuese dhe monitoruese për çështjet rinore, të cilat shërbejnë si platformë për bashkëpunim mes institucioneve publike lokale, Këshillit Qendror, organizatave rinore, organizatave për të rinjtë dhe grupeve joformale në komunat përkatëse.

Neni 16, paragrafi 6, ndryshohet si në vijim:

6. Drejtoria komunale e rinisë dërgon njoftimin për përbërjen e Këshillit Lokal te kryetari/ja i/e komunës. Këshilli Lokal njihet nga kryetari/ja i/e komunës përkatëse me mandat trevjeçar (3).

Neni 16, paragrafi 9, ndryshohet si në vijim:

9. Procedurat e themelimit, organizimit dhe funksionimit të Këshillave Lokalë rregullohen me akt nënligjor nga ministria përkatëse për rini dhe aktet normative të Këshillit.

Amendamenti 10

Neni 17, pas paragrafit 3, shtohet paragraf i ri me këtë përmbajtje:

Dy apo më shumë komuna mund të hyjnë në bashkëpunim nderkomunal për mbështetjen e një qendre rinore e cila i shërben të rinjve të atyre komunave.

Neni 17, paragrafi 5, ndryshohet si në vijim:

5. Organizatat e pajisura me leje për menaxhimin e qendrave rinore sigurojnë mbështetje financiare për zbatimin e planit vjetor të aktiviteteve nga komuna. Institucionet publike qendrore dhe donatorët e jashtëm mund të ofrojnë mbështetje financiare shtesë.

Amendamenti 11

Neni 18, paragrafi 4, ndryshohet si në vijim:

4. Strategjia zbatohet me mjete nga buxheti i Republikës së Kosovës.

Amendamenti 12

Neni 21, paragrafi 2, ndryshohet si në vijim:

2. Agjencia ka përgjegjësi të promovojë vullnetarizmin rinor dhe të ofrojë certifikime për punë vullnetare. Puna vullnetare e certifikuar shërben në proceset e punësimit dhe edukimit.

Amendamenti 13

Neni 22, paragrafi 2, ndryshohet si në vijim:

2. Këshilli Qendror dhe Këshillat Lokal bëjnë evidencimin e anëtarëve sipas legjislacionit në fuqi.

Anëtarët e Komisioni me gjashtë (6) vota për, asnjë kundër e abstenim miratuan amendamentet e për këtë projektligj dhe të njëjtat procedohen tek Komisionet e përhershme për vlerësim.

4. Shqyrtimi i Projektligjit Projektligjit nr.08/L-277 për Sport

Ardian Gola, si kryesues tha se Grupi punues ka bërë shqyrtimin e Projektligjit nr.08/L-277 për Sport, gjithashtu lidhur me këtë Projektligj janë mbajtur dy Dëgjime Publike.

Lidhur me këtë projektligj ka pasur gjithsejt tetëmbëdhjetë (18) amendamente nga deputeti Bekim Haxhiu të cilin e falenderon për bashkëpunimin dhe konstruktivitetin.

Grupi punues ka paraparë gjithsejt katërdhjetë e shtatë (47) amendamente si në vijim

Amendamenti 1 – dy propozime

A) Komisioni Funkcional

Neni 1, ndryshohet si në vijim:

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për organizimin, zhvillimin dhe financimin e sportit dhe aktivitetit fizik në Republikën e Kosovës, në një ambient të sigurt, dhe promovimi i shëndetit dhe mirëqenies së sportistëve dhe shoqërisë në përgjithësi.

B) Deputeti Bekim Haxhiu – pa përkrahjen e Komisionit funksional

Neni 1. Qëllimi

Të ndryshohet si në vijim:

Neni 1

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i normave ligjore të organizimit dhe zhvillimit të sportit, promovimi i shëndetit dhe mirëqenies së sportistëve, mbrojtjen e të drejtave të sportistëve dhe atyre që merren me sport dhe edukim fizik në Republikën e Kosovës, në përputhje me Kartën Evropiane të Sportit dhe me rekomandimet e organizatave ndërkombëtare sportive. Përcaktimin e rregullave të funksionimit dhe kompetencat e institucioneve shtetërore dhe organizatave sportive dhe përcaktimin e përgjegjësive ndërmjet institucioneve shtetërore dhe organizatave sportive.

Amendamenti 2

Neni 2, ndryshohet si në vijim:

Ky ligj zbatohet nga të gjitha institucionet, organizatat dhe personat që përfshihen në veprimtarinë sportive dhe në aktivitetin fizik.

Amendamenti 3

Deputeti Bekim Haxhiu – pa përkrahjen e Komisionit Funkcional

Neni 3. Përkufizimet

Të ndryshohet si në vijim:

Neni 3

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këto kuptime:

1.1. Aktivitet fizik – çdo lëvizje trupore e shkaktuar nga muskujt skeletorë që kërkon shpenzim të energjisë;

1.2. Agjencia (Agjencia Shtetërore Anti Doping): është institucioni i vetëm Ekzekutiv i Administratës Shtetërore dhe përgjegjës parësor për zbatimin e rregullave anti-doping, drejtimin e mbledhjes së mostrave, menaxhimin e rezultateve të testeve dhe menaxhimin e rezultateve në nivel kombëtar;

1.3. Agjencia Botërore e Antidopingut (WADA): është një organizatë e pavarur ndërkombëtare jofitimprurëse, e cila drejton një lëvizje bashkëpunuese mbarë botërore për sport pa doping, të përbërë dhe financuar nga lëvizja sportive dhe qeveritë në mbarë botë;

1.4. Doping në sport: shkelja e një ose më shumë rregullave anti-doping të përcaktuara në Kod dhe siç janë transpozuar në Rregullat Kombëtare Anti-Doping;

1.5. Anti-Doping: është ndërmarrja e të gjitha masave për pengimin, zbulimin dhe shmangien e dopingut;

1.6. Edukimi fizik: është lëndë mësimore, pjesë e kurrikulës së arsimit parauniversitar dhe universitar, e cila fokusohet në zhvillimin e aftësive që ndihmojnë në kryerjen me lehtësi dhe kënaqësi të veprimtarisë fizike ditore. Nëpërmjet saj fitohen aftësitë e nevojshme për të marrë pjesë në një gamë të gjerë veprimtarish sportive

1.7. Fair play: është loja e ndershme, respektimi i rregullave dhe trajtimi i barabartë i të gjithë pjesëmarrësve.

1.8. Federata sportive: është personi juridik, që krijohet në formën e shoqatës, anëtarë të së cilës janë klubet sportive që ushtrojnë veprimtari në një sport të caktuar, dhe që ka për qëllim organizimin, zhvillimin, promovimin, kontrollin, rregullimin dhe përhapjen e një sporti të caktuar në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

1.9. Klub sportiv: është personi juridik, që ushtron veprimtari sportive në një sport ose shumë sporte.

1.10. KAS – Këshilli i Arbitrazhës Sportive;

1.11. Komiteti Olimpik Ndërkombëtar: është një organizatë e pavarur jofitimprurëse, e cila drejton Lëvizjen Olimpikë Botërore.

1.12. Komiteti Olimpik i Kosovës: është një organizatë e pavarur jofitimprurëse, e cila drejton lëvizjen olimpikë në Kosovë.

1.13. Komiteti Praolimpik i Kosovës: është një organizatë e pavarur jofitimprurëse, e cila drejton lëvizjen olimpikë për personat me paaftësi të kufizuar në Kosovë.

1.14. Mjedis sportiv: është një hapësirë e mbuluar ose jo, e rrethuar ose jo, e destinuar për organizimin e veprimtarive sportive, si lojëra sportive, gara sportive, palestra sportive ose fitnesi apo e përdorur përkohësisht për organizimin e veprimtarive sportive promovionale, lojërave zbavitëse dhe veprimtarive sportive rekreative.

1.15. Objekt sportiv: është sendi i paluajtshëm, i ndërtuar në përputhje me kushtet e nevojshme për zhvillimin e një apo disa sporteve, në bazë të rregullave teknike, të miratuara nga federata kombëtare e sportit përkatës.

1.16. Organizatë sportive: është Komiteti Olimpik i Kosovës, federatat, klubet sportive dhe shoqatat, të cilat zhvillojnë veprimtari sportive.

1.17. Sporti: është veprimtaria për zhvillimin e gjithanshëm me qëllim që të përmirësojë shëndetin dhe aftësitë fizike nëpërmjet ushtrimeve fizike, lojërave të ndryshme dhe garave sipas rregullave të caktuara.

1.18. Sportisti : është person që ushtron një ose disa lloje sporti, pjesëtar i skuadrës së një shoqërie ose klubi sportiv. 21. “Sportistë të nivelit të lartë” janë persona që praktikojnë sistematikisht dhe në mënyrë të organizuar sportin, duke marrë pjesë në veprimtari sportive dhe duke arritur rezultate të larta në aktivitete

kombëtare dhe ndërkombëtare.

1.19. Sport amator: është veprimtaria sportive, ku pjesëmarrësit për përgatitjen dhe përfaqësimin në të mbështeten te vullnetarizmi.

1.20. Sport profesionist: është veprimtaria e sportistëve, të cilët zhvillojnë veprimtari sportive në mënyrë profesionale dhe që janë të pajisur me kontratë me klubin përkatës nga i cili paguhen.

1.21. Sport shkollor: është veprimtaria e organizuar kurrikulare dhe ekstrakurrikulare, nëpërmjet së cilës menaxhohen dhe trajnohen aftësitë kryesore të nxënësve për t’u përfshirë në ushtrimin e disiplinave të ndryshme sportive.

1.22. Shoqatë sportive: është personi juridik, që krijohet nga anëtarët që ushtrojnë veprimtari sportive në territorin e Republikës së Kosovës, sipas dispozitave të këtij ligji dhe të legjisllacionit në fuqi.

1.23. Trajnim sportiv – ndërmarrja e çfarëdolloj procesi trajnues të sportistit, trajnerit, gjyqtarit dhe personave të tjerë të përfshirë në sport që ka për qëllim zhvillimin e karakteristikave antropologjike dhe aftësive motorike e funksionale, si dhe përvetësimi i aftësive motorike për një sport të caktuar ose degë sportive

1.24. Lojë tradicionale – formë e aktivitetit fizik e cila ka karakter garues dhe zhvillohet në Republikën e Kosovës, në rajone të ndryshme të territorit të saj apo vetëm në një rajon, që për

shkak të historisë së zhvillimit të lojës apo organizimit të garave për një kohë të gjatë dhe që është përcjellur në breza të ndryshëm, konsiderohet lojë tradicionale;

1.25. Personi që kryen punë profesionale në sport – trajneri, instruktori, personi zyrtar që organizon dhe udhëheq garë sportive dhe personat tjerë zyrtarë sipas akteve përkatëse të organizatave sportive;

1.26. Person Zyrtar: është për personi udhëheqës i KOK, federatave, klubeve dhe zyrtarët përgjegjës në organizim të ndeshjeve vendore dhe ndërkombëtare.

1.27. Rekreacion sportiv – aktivitet fizik qoftë i planifikuar dhe programuar ose jo, që ka qëllim zhvillimin e aftësive psiko-fizike dhe shëndetit, pa pjesëmarrje në gara sportive zyrtare;

1.28. Ndërmjetësim sportiv – zhvillimi i aktivitetit të ndërmjetësimit ose përfaqësimit të sportistit apo trajnerit në marrëdhënien e tij të punës, si dhe aktiviteti i ndërmjetësimit apo përfaqësimit të klubit sportiv;

1.29. Veprimtari sportive – të gjitha format e veprimtarive fizike e sportive të tilla si pjesëmarrja në garë sportive, trajnimi sportiv, edukimi sportiv, ushtrimet sportive, organizimi dhe udhëheqja e garës sportive dhe ndërmjetësimi sportiv. Veprimtari sportive konsiderohet edhe organizimi i aktivitetit shkollor sportiv jashtëkurrikular, aktivitetit akademik sportiv, aktivitetit sportiv të punëtorëve, menaxhimi i infrastrukturës sportive dhe veprimtaritë e tjera administrative ose menaxheriale në kuadër të personave juridikë si pjesë e sportit.

Amendamenti 4

Deputeti Bekim Haxhiu – pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL

Neni 4. Sporti

Të ndryshohet si në vijim:

Neni 4

1.Sporti është forme aktiviteti fizik që përmes ushtrimeve dhe lojës në formë të garave apo aktiviteteve shoqërore sociale synon të mirëmbajë ose përmirësojë shëndetin dhe aftësitë fizike të pjesëmarrësve.

2.Sporti është veprimtari e interesit të veçantë publik dhe shtetëror në Republikën e Kosovës.

3.Sporti zhvillohet në bazë Ligjit për Sport dhe rregullave të përcaktuara nga organizatat sportive. Sporti zhvillohet në frymën e bashkëpunimit në mes të institucioneve të të gjitha niveleve, bashkëpunimit të tyre me organizatat sportive, dhe bashkëpunimit në mes të këtyre organizatave.

4. Qeveria e Republikës së Kosovës në bazë të propozimit të Ministrisë përgjegjëse për sport miraton Strategjinë Shtetërore për Sportin.

5. Të gjitha dokumentet e institucioneve publike të nivelit qendror dhe atij lokal, si dhe statutet, rregulloret, dokumentet strategjike të organizatave të sportit, përfshirë planet e punës, hartohen në përputhje me Strategjinë Shtetërore të Sportit dhe Ligjin për Sport.

6. Organet përgjegjëse për edukimin fizik dhe të sportit, janë të detyruara që të angazhohen për të zhvilluar veprimtarinë sportive si fushë të interesit publik dhe shtetëror.

Amendamenti 5 – dy propozime

A) Komisioni FunkSIONAL

Neni 5, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, ndryshohet si në vijim:

1.2.Ligjshmëria - veprimet duhet të jenë në përputhje me dispozitat e këtij ligji ose legjislacionit tjetër përkatës në fuqi. Çdo kufizim ose ndalim i një të drejte në fushën e sportit duhet të bazohet në ligj ose aktet normative bazë të personit juridik që merr pjesë në veprimtari sportive;

Neni 5, paragrafi 1, nënparagrafi 1.10, ndryshohet si në vijim:

1.10. Fair-play – sporti zhvillohet në bazë të rregullave, konkurrencës së ndershme, respektit ndaj kundërshtarit, parandalimit dhe shmangies së dhunës dhe sjelljes jo të drejtë.

B) Deputeti Bekim Haxhiu – pa përkrahjen e Komisionit funksional

Neni 5.

Paragrafët 1.2, 1.3, dhe 1.10 të ndryshohen si në vijim:

Neni 5

1.2. Ligjshmëria - është një sistem i normave ligjore dhe shoqërore të cilat duhet të i respektojnë të gjithë pjesëmarrësit në sport. Veprimet e pjesëmarrësve në sport duhet të jenë në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe legjislacionit tjetër përkatës në fuqi që ndërlidhen me organizimin, funksionimin dhe financimin e sporti dhe organizatave sportive.

1.3. Qeverisja e mirë - respektimi dhe zbatimi i Kodit të Qeverisjes së Mirë të përcaktuar me këtë ligj dhe legjislacionin tjetër në Republikën e Kosovës, respektimi i rregullave përkatëse etike dhe rregullave të tjera ndërkombëtare për qeverisjen e mirë;

1.10. Fair-play : është një koncept i vlerave themelore në sport që përfshin konkurrencën e ndershme, respektin, miqësinë, shpirtin ekipor, barazinë, sportin pa doping, respektimin e rregullave të shkruara dhe të pashkruara si integriteti, solidariteti, toleranca, kujdesi, përsosmëria dhe gëzimi, janë bazament i organizimit të lojës së ndershme e cila mund të përjetohet dhe mësohen brenda dhe jashtë fushës.

Amandamenti 6

Neni 6, paragrafi 4, ndryshohet si në vijim:

4. Procedura e njohjes së sporteve nga nënparagrafi 1.6 i paragrafit 1 i këtij neni përcaktohet me akt nënligjor sipas nenit 29 të këtij ligji.

Amendamenti 7

Deputeti Bekim Haxhiu – pa përkrahjen e Komisionit funksional

Neni 7. Pjesëmarrësit në sport

Të ndryshohet Paragrafi 3, Nenparagrafi 8, si në vijim:

Neni 7

Paragrafi 3

Nenparagrafi 8.

Shoqatat rekreative dhe shoqatat tjera që përfaqësojnë të drejtat e sportistëve, trajnerëve, klubeve gjyqtarëve të sportit, etj.

Amendamenti 8

Deputeti Bekim Haxhiu – pa përkrahjen e Komisionit Funksional

Neni 8.

Të ndryshohen si në vijim:

Neni 8

Sportisti

1. Sportist profesionist është sportisti i punësuar me kontratë pune profesionale parësore në një klub, shoqatë apo federatë sportive. Kontrata e punës e sportistit profesionist duhet të përfshijë pagesën e rregullt, pagesën për ushtrime, lojë dhe garat sportive, shpërblimet dhe kompensimet tjera.

2. Sportistë amatorë është sportisti i cilët nuk ka kontratë pune profesionale si sportist të lidhur me klubin sportiv apo shoqatën ku është regjistruar. Sportisti amatorë në marrëveshje me klubin mund të nënshkruaj kontratë për pagesë të sportistit amatorë për mbulim të shpenzimeve për, ushtrime dhe lojë, udhëtim, banim, ushqim apo bursë për shkollim, pagesa e sportistit amatorë nuk mund ta kaloj shumën e pagesës së sportistit profesionist.

3. Federatat Sportive me rregullore të veçantë përcaktojnë shumë minimale të pagesës vjetore neto të kontratës së punës të sportistit profesionist.

4. Në rastet kur shumën e pagesës vjetore të sportistit amatorë arrijn shumën e pagesës vjetore të sportistit profesionist, atëherë ai konsiderohet sportist profesionist dhe kontrata e tij është kontrata profesionale e punës.

5. Për të nënshkruar kontratë profesionale sportisti duhet të jetë së paku 18 vjeçar.

6. Sportist rekreativ është çdo person tjetër që zhvillon aktivitet të rekreacionit sportiv siç përkufizohet me këtë ligj.

Amendamenti 9

Neni 9, paragrafi 6, ndryshohet si në vijim:

6. Për ushtrimin e veprimtarisë së trajnerit apo instruktorit, Federatat sportive mund të përcaktojnë kërkesa shtesë që lidhen me specifikat e sportit përkatës.

Amendamenti 10

Deputeti Bekim Haxhiu – pa përkrahjen e Komisionit Funkcional

Neni 10.

Të ndryshohen si në vijim:

Neni 10

Personat zyrtarë në sport

1. Veprimtaria sportive, paraqet një fushë të rëndësishme të interesit publik e shtetëror, e cila zhvillohet mbi bazë të vullnetarizmit ose të profesionalizmit.

2. Përsona zyrtarë në sport janë udhëheqësit e federatave sportive dhe të Komitetit Olimpik, personat që marrin pjesë në organizimin dhe udhëheqjen e garës sportive: gjyqtari sportiv, delegati sportiv, komisioneri sportiv dhe personi tjetër që përcaktohet me akt normativ të federatës përkatëse.

3. Kushtet dhe mënyra e ushtrimit të veprimtarisë sportive e personave zyrtarë nga paragrafi 1 përcaktohen me këtë ligj dhe akt normativ nga federata përkatëse.

4. Në sportet e organizuara në kuadër të Komitetit Paraolimpik, Federatës së Sporteve të Shurdhërve të Kosovës dhe Olimpiadës Speciale, marrin pjesë personat zyrtarë të përcaktuar sipas rregullave të këtyre organizatave, në përputhje me rregullat e zbatueshme ndërkombëtare.

Amendamenti 11

Neni 11, paragrafi 2, ndryshohet si në vijim:

2. Ushtrimi i profesionit të agentit sportiv rregullohet me akt nënligjor të nxjerr nga Ministria përkatëse për Sport.

Amendamenti 12 – dy propozime

A) Komisioni Funkcional

Neni 13, paragrafi 2, ndryshohet si në vijim:

2. Aftësia e sportistit vërtetohet në bazë të kontrollit shëndetësor, i cili duhet të ketë periudhë të caktuar të vlefshmërisë në përputhje me rregullat e federatës përkatëse nderkombëtare duke u bazuar në statusin shëndetësor të sportistit, grupmoshën dhe nivelin garues.

B) Deputeti Bekim Haxhiu – pa përkrahjen e Komisionit Funkcional

Neni 13.

Të ndryshohen si në vijim:

Neni 13

Kontrolli shëndetësor

1. Në trajnim dhe garë sportive të sportit të organizuar mund të marrë pjesë vetëm sportisti për të cilin është e vërtetuar aftësia shëndetësore.

2. Në garat sportive dhe stërvitjet sportive të organizuara në Republikën e Kosovës mund të marrin pjesë vetëm sportistët të cilëve i'u është përcaktuar aftësia shëndetësore për sportin dhe grup moshën e caktuar.

3. Aftësia shëndetësore e sportistit vërtetohet në bazë të kontrollit mjekësorë të kryer në institucion shëndetësorë përkatës të licencuar, vlefshmëria e aftësisë shëndetësore ka periudhë të caktuar jo më të gjatë se 1 vit dhe e detyrueshme të kryhet çdo 6 muaj para fillimi të çdo sezone të stërvitjeve dhe garave sportive.

4. Kontrolli shëndetësor sipas këtij neni bëhet nga institucionet e licencuara të nivelit sekondar apo terciar shëndetësor nga fusha e mjekësisë sportive.

5. Federata përkatëse mund të përcaktoj kritere shtesë për kontroll shëndetësor të sportistit në përputhje me paragrafët e këtij neni. Për garat në kategoritë e reja federate përkatëse kontrollin mjekësor mund ta bëjnë më shpesh se 6 muaj.

6. Kontrolli mjekësor për garat sportive të nxënësve, studentëve, veteranëve dhe personave me aftësi të kufizuar, përcaktohet me rregullore të veçantë të organit që udhëheq më këto gara sportive.

Amendamenti 13 – dy propozime

A) Komisioni Funkcional

Neni 14, paragrafi 1, ndryshohet si në vijim:

1. Kontrata në mes sportistit profesionist dhe klubit sportiv lidhet në formë të shkruar, noterizohet dhe regjistrohet në Federatën përkatëse sportive në përputhje me aktet normative të Federatës.

B) Deputeti Bekim Haxhiu – pa përkrahjen e Komisionit Funkcional

Neni 14.

Të ndryshohen paragrafi 1 dhe 5 si në vijim:

Neni 14

Kontrata e sportistit profesional

1. Kontrata e marrëdhënies së punës në mes sportistit profesionist dhe klubit sportiv lidhet në formë të shkruar duhet të jetë e noterizuar dhe regjistrohet në federatën përkatëse sportive në përputhje me aktet normative të federatës.

5. Gjatë periudhës së njëjtë kohore sportisti mund të lidhë vetëm një kontratë profesionale

6. Kontratat e përcaktuara në këtë nen mund të parashohin rregullim të veçantë nga legjislacioni përkatës që rregullon marrëdhënien e punës, sipas marrëveshjes mes sportistit dhe organizatës sportive, por duhet të përmbushin kriteret e caktuara me këtë nen si dhe kushtet e sigurisë dhe të shëndetit në punë të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

7. Federatat përkatëse sportive mund të përcaktojnë rregulla shtesë për kontratat e sportistëve, si dhe kërkesa për lidhjen e kontratave sportive mes klubeve dhe sportistëve, për të garuar në nivele të caktuara të garave sportive.

Amendamenti 14

Neni 13, ndryshohet si në vijim:

Personat e tjerë që kryejnë punë profesionale në sport ushtrojnë veprimtarinë e tyre sportive në bazë të marrëveshjes me organizatën sportive, sipas legjislacionit në fuqi dhe rregullave të federatës përkatëse.

Amendamenti 15

Neni 17, paragrafi 2, ndryshohet si në vijim:

2.KOK funksionon në formën e organizatës joqeveritare dhe ushtron aktivitetin në përputhje me këtë ligj, ligjin për OJQ, statutin dhe aktet normative të tij, si dhe rregullat përkatëse të Komitetit Olimpik Ndërkombëtar.

Neni 17, nen paragrafi 3.6, ndryshohet si në vijim:

3.6. mbështetja dhe promovimi i arritjeve kulminante sportive të sportistëve dhe pjesëmarrjes së tyre në ekipet shtetërore sportive në Lojërat Olimpike, kampionatet dhe garat e tjera ndërkombëtare;

Amendamenti 16

Neni 18, paragrafi 4, ndryshohet si në vijim:

4.Organizatat nga ky nen funksionojnë në formën e organizatave joqeveritare dhe ushtrojnë aktivitetin e tyre në përputhje me këtë ligj, ligjin për OJQ, statutin dhe aktet normative të tyre dhe rregullat përkatëse të organizatave ndërkombëtare në të cilat janë anëtare.

Amendamenti 17 – dy propozime

A) Komisioni funksional

Neni 19, nënparagrafi 4.2, ndryshohet si në vijim:

4.2.Bordi/Komiteti ekzekutiv;

4.2.1. së paku një anëtar i Bordit/Komitetit ekzekutiv duhet të jetë përfaqësues i sportistëve;

Neni 19, paragrafi 6, ndryshohet si në vijim:

6.Për ushtrimin e veprimtarisë së saj, federata sportive miraton aktet e brendshme normative përkatëse, në përputhje me këtë ligj, ligjin për OJQ, legjislacionin tjetër në fuqi si dhe rregullat përkatëse të organizatave ndërkombëtare në të cilat janë anëtare.

Neni 19, pas paragrafit 6, shtohet paragraf i ri me këtë përmbajtje:

7.Federatat sportive obligohen që të gjitha aktet e tyre normative t'i bëjnë publike në faqen e tyre zyrtare.

Paragrafët tjerë redniten sipas radhës.

B) Deputeti Bekim Haxhiu – pa përkrahjen e Komisionit funksional

Neni 19.

Të ndryshohen shtohen paragrafet si në vijim:

Neni 19

Federata sportive

1. Federata sportive përmban emrin Kosovë në emërtimin e saj si dhe e ka logon në përputhje me identitetin e Republikës së Kosovës dhe të sportit përkatës, Federata sportive janë autoritet publike dhe përfaqësuese sportive të rexhistruara sipas legjislacionit në Republikën e Kosovës.

2. Logoja e Federatave sportive në Republikën e Kosovës janë të mbrojtura, përdoret në të gjitha komunikimet zyrtare të federative. Askush nuk mund ta përdorë logon e federatave pa miratimin paraprak të Bordit të Federatës.

3. Federatat sportive janë subjekte juridike, të cilat veprojnë në pajtueshmëri me Ligjin për sportin, legjislacionin tjetër të aplikueshëm në Kosovë dhe aktet normative të federatave ndërkombëtare sportive përkatëse ku janë të anëtarësuara.

4. Federatat sportive regjistrohen si organizatë jofitimprurëse, kanë xhirollogarinë e vet bankare dhe për obligimet dhe detyrimet e veta përgjigjet me të gjitha mjetet e saj

5. Për ushtrimin e veprimtarisë së saj, federata sportive miraton akte normative përkatëse të brendshme, të cilat bëhen publike në faqen e saj zyrtare. Statuti dhe aktet tjera normative të federatave duhet të jenë në përputhje me Ligjin e Sporti dhe legjislacionin tjetër në Republikën e Kosovës. Federata sportive të cilat nuk harmonizojnë Statutin dhe aktet normative me Ligjin për Sport dhe ligjet tjera në Republikën e Kosovës nuk mund të licencohen, në rastet kur federatat nuk respektojnë ligjet e Kosovës u revokohet licenca.

Amendamenti 18

Neni 21, paragrafi 9 dhe 10, ndryshohen si në vijim:

9. Ndryshimi i statusit juridik të klubit sportiv nga organizatë joqeveritare në shoqëri tregtare mund të bëhet në përputhje me kriteret e përcaktuara në ligjin përkatës për lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare.

10. Ministria përgjegjëse për Sport me akt nënligjor rregullon kriteret sportive dhe procedurën përkatëse për ndryshimin e statusit juridik të klubeve.

Amendamenti 19

Neni 22, paragrafi 3, ndryshohet si në vijim:

3. Federata e Sportit Universitar e Kosovës është federatë shumësportive, e cila funksionon në formën e organizatës jo-qeveritare dhe kujdeset për zhvillimin, promovimin dhe mbrojtjen e sportit në institucione të nivelit të arsimit të lartë.

Neni 22, paragrafi 6, ndryshohet si në vijim:

6. Strukturat organizative të Federatës së Sportit Shkollor dhe Federatës së Sportit Universitar duhet të kenë së paku organet qeverisëse të përcaktuara me paragrafin 4 të nenit 19 të këtij ligji.

Neni 22, paragrafi 9, ndryshohet si në vijim:

9. Detyrat dhe përgjegjësitë e tjera të veçanta të federatave përcaktohen me aktet e brendshme normative përkatëse, në përputhje me këtë ligj, ligjin për OJQ, legjislacionin tjetër në fuqi si dhe rregullat përkatëse të organizatave ndërkombëtare në të cilat janë anëtare.

Amendamenti 20

Neni 23, paragrafi 3, ndryshohet si në vijim:

3.Struktura organizative e shoqatave nga paragrafi 1 duhet të ketë së paku organet qeverisëse të përcaktuara në paragrafin 4 të nenit 19 të këtij ligji.

Neni 23, paragrafi 4, ndryshohet si në vijim:

4.Detyrat dhe përgjegjësitë e tjera të veçanta të shoqatave përcaktohen me aktet e brendshme normative përkatëse, në përputhje me këtë ligj, ligjin për OJQ, legjislacionin tjetër në fuqi si dhe rregullat përkatëse të organizatave ndërkombëtare në të cilat janë anëtare.

Amandamenti 21

Deputeti Bekim Haxhiu – pa përkrahjen e Komisionit funksional

Neni 27.

Të ndryshohen paragrafi 1, si në vijim:

Neni 27

Organizimet për mbrojtjen dhe avokimin për të drejtat e sportistëve dhe personave të përfshirë në sport

1.Në Republikën e Kosovës themelohen shoqatat e sportistëve, shoqatat e trajnerëve , shoqata e klubeve dhe shoqatat e personave të tjerë të përfshirë në sport, të cilat mbrojnë dhe avokojnë për drejtat e anëtarëve të tyre pranë organizatave, federatave, klubeve apo autoriteteve të tjera përkatëse.

Amandamenti 22

Neni 29, paragrafi 1 ndryshohet si në vijim:

1.Federata e sportit përkatës themelohet dhe regjistrohet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare dhe këtij ligji.

Neni 29, paragrafi 2 ndryshohet si në vijim:

2.Aplikanti për regjistrimin e federatës së sportit përkatës sipas paragrafit 1 të këtij neni, me qëllim të përdorimit të ligjshëm të emrit “Federatë” në emrin e organizatës dhe me qëllim të përfaqësimit dhe organizimit zyrtar të garave vendore e nderkombëtare, si dhe përfitimit të fondeve nga institucionet publike plotëson kriteret bazë sportive në vijim, tek Agjencia për Sport:

Neni 29, paragrafi 7, ndryshohet si në vijim:

7.Brenda periudhës një (1) vjeçare të lejimit të ushtrimit të veprimtarisë sipas dispozitave përkatëse të këtij ligji, Federata duhet të dëshmoj tek Agjencia plotësimin e kushteve nga Neni 19 i këtij ligji.

Amandamenti 23

Neni 31, ndryshohet si në vijim:

Neni 31

Pezullimi dhe revokimi i lejes së Federatës së sportit përkatës

1.Pezullimi i lejes së Federatës së sportit përkatës bëhet kur:

1.1.leja është siguruar në bazë të dokumenteve falsifikuara apo informacionit tjetër jo të vërtetë;

1.2.themeluesit dhe përfaqësuesit e strukturave qeverisëse ushtrojnë veprimtari për qëllime tjera nga ato që janë përcaktuar në aktin e themelimit;

1.3.dështon vazhdimisht të raportojë për fondet e pranuar publike, dhe dështon vazhdimisht në procesin e nënshtrimit të kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm të auditimit të menaxhimit të parasë publike;

1.4.shkelen dispozitat e këtij ligji të cilat pamundësojnë zhvillimin e sportit të caktuar.

2. Pezullimi ka karakter të përkohshëm, ku federatës së sportit përkatës i ofrohet mundësia për të përmirësuar shkëlqjen e konstatuar nga paragrafi 1 i këtij neni, në afatin e përcaktuar.

3. Në rast të mosveprimit sipas udhëzimeve nga Agjencia e Sportit, federatës së sportit përkatës i revokohet leja.

4. Agjencia e Sportit është përgjegjëse për pezullimin dhe revokimin e lejes së federatës sipas detyrës zyrtare apo në bazë të propozimit të Inspektoratit për Sport.

5. Kundër vendimit të Agjencisë nga paragrafi 4 i këtij neni, pala e pakënaqur mund të parashtroj ankesë në Ministrinë përgjegjëse për Sport.

6. Ky nen zbatohet përshtatshëmrisht edhe për Federatën e Sportit Shkollor të Kosovës, Federatën e Sportit Universitar të Kosovës dhe shoqatat sportive të punëtorëve.

7. Ministria përgjegjëse për sport me akt nënligjor të nxjerrë sipas nenit 29, paragrafi 8, përcakton procedurën për pezullimin dhe revokimin e lejes së federatës sportive.

Amandamenti 24

Neni 36, paragrafi 1, ndryshohet si në vijim:

1. Agjencia e Sportit është agjenci ekzekutive e cila themelohet me këtë ligj në kuadër të Ministrisë përgjegjëse për Sport. Detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë janë si në vijim:

Neni 36, nën paragrafi 1.8., ndryshohet si në vijim:

1.8. lëshon lejen e federatave sportive për zhvillimin e veprimtarisë së tyre në territorin e Republikës së Kosovës;

Amandamenti 25 - Dy propozime

A) Komisioni funksional

Neni 37, paragrafi 1, ndryshohet si në vijim:

1. Inspektorati i Sportit është agjenci ekzekutive, e cila themelohet me këtë ligj dhe vepron në kuadër të Ministrisë përgjegjëse për Sport.

B) Deputeti Bekim Haxhiu – pa përkrahjen e Komisionit funksional

Neni 37 dhe 38 të fshihen.

Neni 37 Inspektorati i Sportit

Neni 38 Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të Inspektoratit të Sportit

Amandamenti 26

Deputeti Bekim Haxhiu – pa përkrahjen e Komisionit funksional

Neni 39.

Të ndryshohet si në vijim:

Neni 39

Këshilli Shtetëror për Sport

1. Këshilli Shtetëror për Sport është organ këshillues me ekspertizë profesionale në fushën e sportit, i cili diskuton çështje të rëndësishme për sportin dhe ofron rekomandime për Ministrinë përgjegjëse për Sport dhe Kuvendin e Republikës së Kosovës.

3. Këshilli Shtetëror për Sport përbëhet nga Ministri përgjegjës për Sport, kryetari Komisionit Parlamentar për Sport dhe nëntë (9) anëtarë ekspertë të zgjedhur nga Kuvendi I Kosovës.

4. Tre (3) nga anëtarët e Këshillit nominohen nga autoritetet si në vijim:

4.1. një (1) anëtar nominohet nga Agjencia e Sportit;

4.2. një (1) anëtar nominohet nga KOK;

4.3. një (1) anëtar nominohet nga KPK, Olimpiada Speciale e Kosovës dhe FSSHK sipas rotacionit;

5. Gjashtë (6) anëtarët e tjerë në Këshill zgjidhen nga Kuvendi I Kosovës të cilët propozohen nga Komisioni Parlamentar për Sport:

5.1. një (1) nga radhët e profesorëve universitar të edukimit sportiv;

5.2. një (1) nga radhët e organizatave të shoqërisë civile në fushën e sportit;

5.3. një (1) nga radhët e sportistëve aktiv profesional në Kosovë;

5.4. një (1) nga radhët e trajnerëve aktiv në Kosovë; dhe

5.5. një (1) nga radhët e klubeve të sportit në Kosovë.

5.6. një (1) nga radhët e personaliteteve të shquara të sportit në Kosovë, fitues të medaljeve olimpike.

6. Kuvendi i Kosovës ofron përkrahje logjistike dhe financiare për mbarëvajtjen e punës së Këshillit.

9. Me akt nënligjor përcaktohet organizimi, funksionimi, mënyra e punës dhe kompensimi financiar për Këshillin Shtetëror për Sport.

Amandamenti 27

Neni 42, ndryshohet si në vijim:

Instituti për Kërkime Shkencore në Fushën e Sportit themelohet në përputhje me ligjislacionin përkatës në Republikën e Kosovës.

Amandamenti 28

Neni 43, ndryshohet si në vijim:

Neni 43

Këshilli kundër dukurive negative në sport

Këshilli kundër dukurive negative në sport funksionon në përputhje me ligjin e veçantë.

Amandamenti 29

Neni 45, ndryshohet si në vijim:

1. Mjetet për financimin e sportit në nivel qendror dhe lokal sigurohen nga buxheti i Republikës së Kosovës dhe instrumentet tjera të financimit.

2. Financimi i sportit sigurohet edhe nga:

2.1. Kryerja e aktiviteteve sportive;

2.2. Anëtarësimet përkatëse;

2.3. Sponsorizimet dhe donacionet;

2.4. Fondet dhe instrumentet ekonomike me të cilat institucionet publike financojnë sportin;

2.5. Realizimi i aktiviteteve ekonomike;

2.6. Të hyrat nga instrumentet ekonomike të përcaktuara nga legjislacioni tatimor;

2.7. Granti specifik i përcaktuar me legjislacionin përkatës për financat e pushtetit lokal;

2.8. Mjetet tjera financiare të fituara në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Të hyrat që krijohen nga parashikimi i ligjit për sport derdhen në buxhetin e shtetit dhe ndahen sipas legjislacionit në fuqi.

Amandamenti 30

Neni 46, paragrafi 4, ndryshohet si në vijim:

4.Procedura dhe kushtet për financim nga ky nen përcaktohen me akt nënligjor të miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, me propozim të Ministrisë përgjegjëse për Sport.

Aandamenti 31

Neni 47, ndryshohet si në vijim:

Neni 47

Stimulimi financiar për arritjen e rezultateve sportive, shpërblimet financiare dhe kompensimi i përhershëm financiar

1.Sportistët dhe trajnerët që arrijnë rezultate sportive kulminante në lojërat olimpike, lojërat paraolimpike, në gara të nivelit botëror dhe evropian, shpërblehen financiarisht.

2.Sportistët dhe trajnerët që arrijnë rezultate sportive kulminante në lojërat olimpike, garën e nivelit botëror ose evropian, ju takon shpërblim i caktuar financiar.

3.Të drejtën për kompensim të përhershëm financiar e ka sportisti që duke përfaqësuar Republikën e Kosovës ka fituar medalje olimpike, paralimpike, medalje në garën e nivelit botëror ose evropian.

4.E drejta për kompensim të përhershëm financiar fitohen vetëm për arritjen më të lartë të sportistit në sportin përkatës.

5.Vlera e kompensimit të përhershëm financiar nga ky nen ofrohet në baza mujore dhe caktohet nga Ministri përgjegjës për Sport. Vlera e kompensimit rishikohet në përputhje me faktorët ekonomikë.

6.Procesi i financimit nga ky nen udhëheqet dhe zbatohet nga Agjencia e Sportit.

7.Procedura dhe kushtet për zbatimin e financimit nga ky nen përcaktohen me akt nënligjor të miratuar nga Ministri përgjegjëse për Sport.

Amandamenti 32 – dy propozime

A) Komisioni funksional

Neni 49, ndryshohet si në vijim:

Neni 49

Të drejtat e kontributdhënësve në sport

1.Sportistët, trajnerët dhe punëtorët sportiv të cilët kanë ofruar kontributin e tyre në fushën e sportit gjatë periudhës së okupimit të Kosovës nga data 23 mars 1989 deri më 11 qershor 1999 kanë të drejtë të kompensohen për kontributin e tyre në sport.

2.Qeveria e Republikës së Kosovës me propozim të Ministrisë përgjegjëse për Sport nxjerr akt nënligjor që përcakton kriteret, kushtet, procedurën dhe autoritetin vendimmarrës për zbatimin e paragrafit 1 të këtij neni.

B) Deputeti Bekim Haxhiu – pa përkrahjen e Komisionit funksional

Neni 49.

Të ndryshohet si në vijim:

Neni 49

Të drejtat e ish-sportistëve dhe trajnerëve kontribut dhënës

1. Sportistët, trajnerët, punëtorët e administrativ, udhëheqësit dhe donatorët e klubeve, federative dhe KOK të cilët kanë kontribuar në fushën e sportit gjatë periudhës së okupimit të Kosovës nga data 23 mars 1989 deri më 11 qershor 1999, u njihet stazhi i punës, kanë të drejtë për kompensim financiar për kontributin e tyre, me kusht që nuk përfitojnë të hyra të tjera të rregullta.

2. Qeveria e Republikës së Kosovës me akt nënligjor përcakton kushtet, procedurën, autoritetin vendimmarrës dhe çështje të tjera të rëndësishme për zbatimin e paragrafit 1 të këtij neni.

Amandamenti 33

Neni 50, paragrafi 2, ndryshohet si në vijim:

2.Për çështje të njëjtë ndalohet financimi i dyfishtë nga burime të ndryshme të financimit sipas nenit 45 të këtij ligji.

Amandamenti 34

Neni 52, paragrafi 1, ndryshohet si në vijim:

1. Mbikëqyrja e shpenzimit të buxhetit për sport të Republikës së Kosovës bëhet nga Agjencia e Sportit si dhe nga komunat për pjesën e fondeve publike.

Amandamenti 35

Neni 53, ndryshohet si në vijim:

Ministri përgjegjës për Sport ndan çmime sportive në përputhje me nenin 39 të këtij ligji. Llojet e këtyre çmimeve, kushtet dhe procedura përkatëse, përcaktohen me akt nënligjor të miratuar nga Ministri përgjegjës për Sport.

Amandamenti 36

Neni 54, ndryshohet si në vijim:

Neni 54

Ndarja e çmimeve nga organizatat e sportit dhe komunat

Organizatat e sportit dhe komunat kanë të drejtë që përmes akteve të tyre të brendshme të ndajnë çmime vjetore dhe çmime të tjera të ndryshme për sportistët.

Amandamenti 37

Neni 55, ndryshohet si në vijim:

Neni 55

Infrastruktura Sportive

1.Infrastruktura sportive nënkupton një apo disa ndërtesa dhe zona sipërfaqësore të rregulluara, të zhvilluara si të vecanta apo të kombinuara, gjithënjë të pajisura me pajisje sportive përkatëse, në të cilën zhvillohen aktivitetet sportive dhe që i plotëson kushtet e përgjithshme të përcaktuara sipas legjislacionit të ndërtimit, planifikimit hapësinor dhe këtij ligji.

2.Infrastruktura sportive ndahet në infrastrukturë të veçantë sportive dhe infrastrukturë të përgjithme sportive. Kategoritë, nënkategoritë dhe llojet e infrastrukturës sportive përcaktohen me akt nënligjor të nxjerr nga Ministria përgjegjëse për Sport.

3.Infrastruktura sportive mund të jetë në pronësi publike, private, dhe e kombinuar publiko-private.

4.Infrastruktura sportive përfshinë të gjitha përmbajtjet sportive, pavarësisht nëse është e përhershme apo e përkohshme. Infrastruktura sportive gjithashtu mund të përfshijë rrugë, terrene, objekte, apo sipërfaqe të tjera, të cilat rregullisht përdoren për qëllime të tjera, por në të cilat lejohet gjithashtu zhvillimi i aktivitetit sportiv sipas lejes së autoritetit kompetent që menaxhon atë infrastrukturë.

5.Institucionet e Kosovës, mbi bazën e marrëveshjes së caktuar, mund të shfrytëzojnë infrastrukturën sportive private për nevoja të zhvillimit të garave të caktuara me rëndësi për vendin.

Amandamenti 38

Neni 56, ndryshohet si në vijim:

Neni 56

Standardet dhe dimensionet

Federatat sportive me leje për zhvillimin e veprimtarisë së tyre, ndjekin rregullat dhe standardet ndërkombëtare për kategorizimin dhe zhvillimin e infrastrukturës sportive të miratuara nga federatat ndërkombëtare përkatëse. Rregullat dhe standardet ndërkombëtare të ndërlidhura me infrastrukturën sportive bëhen publike në faqen zyrtare të federatës përkatëse.

Amandamenti 39

Neni 57, ndryshohet si në vijim:

Neni 57

Planifikimi dhe investimet në infrastrukturën sportive

1. Infrastruktura sportive planifikohet, zhvillohet dhe ndërtohet përmes investimeve publike, private dhe përmes partneriteteve përkatëse.
2. Financimi i ndërtimit të infrastrukturës së vecantë e cila duhet të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe kushtet e përgjithshme të përcaktuara sipas legjislacionit të planifikimit hapësinor, ndërtimit dhe sipas këtij ligji, bien në kompetencën e institucioneve të nivelit qendror. Ministria përgjegjëse për Sport mund të planifikoj dhe mbështes gjithashtu zhvillimin dhe ndërtimin e infrastrukturës së përgjithshme.
3. Niveli lokal është përgjegjës për financimin e ndërtimit të infrastrukturës së përgjithshme sportive.
4. Ndërtimi i infrastrukturës sportive sipas partneritetit publiko-privat bëhet sipas procedurave të përcaktuara me ligjin përkatës për partneritetin publiko-privat.
5. Modalitetet, rregullat dhe procedurat për planifikimin dhe investimin në infrastrukturë sportive si dhe përcaktimi i nënkategorive sipas nenit 55 të këtij ligji përcaktohen me akt nënligjor të nxjerrë nga ministri përgjegjës për sport.

Amandamenti 40 – dy propozime

A) Komisioni Funkcional

Neni 58, paragrafi 1, ndryshohet si në vijim:

1. Komuna infrastrukturën sportive mund ta rrënojë ose ta ridestinojë mbi bazën e opinionit paraprak të Ministrisë përgjegjëse për Sport.
- Neni 58, në paragrafin 2, shtohet nenparagraf i ri me këtë përmbajtje:
- 2.1. infrastruktura ekzistuese nuk plotëson nevojat dhe kushtet e sigurisë për zhvillimin e aktivitetit sportive.

Nenparagrafet tjerë renditen sipas radhës.

B) Deputeti Bekim Haxhiu – pa përkrahjen e Komisionit funksional

Neni 58.

Të ndryshohet paragrafët 4 dhe 5 si në vijim:

Neni 58

Ridestnimi ose rrënimi i infrastrukturës sportive

4. Infrastruktura sportive mund të jetë në pronësi shtetërore, private apo publiko-private.
5. Institucionet e Kosovës, mbi bazën e marrëveshjes së caktuar, mund të shfrytëzojnë infrastrukturën sportive private për nevoja të zhvillimit të stërvitjeve dhe garave të caktuara me rëndësi për vendin.

Amandamenti 41 – dy propozime

A) Komisioni funksional

Neni 59, ndryshohet si në vijim:

Neni 59

Menaxhimi i Infrastrukturës Sportive dhe Bashkëpunimi Ndërkomunal

1. Menaxhimi i infrastrukturës së vecantë sportive në pronësi shtetërore bëhet nga Ministria përgjegjëse për Sport. Menaxhimi mund t'i besohet me kontratë një apo disa entiteteve të regjistruara për menaxhimin e sipërfaqeve apo objekteve sportive.
2. Menaxhimi i infrastrukturës së përgjithshme në pronësi shtetërore bëhet nga Komuna. Menaxhimi mund t'i besohet me kontratë një apo disa entiteteve të regjistruara për menaxhimin e sipërfaqeve apo objekteve sportive.
3. Dy apo më shumë komuna mund të hyjnë në bashkëpunim ndërkomunal në përputhje me ligjin përkatës për realizimin e investimeve, menaxhimin e infrastrukturës si dhe aspekte të tjera të bashkëpunimit në fushën e sportit.
4. Infrastruktura sportive e cila gjendet në kuadër të institucioneve arsimore publike mund të shfrytëzohet nga federatat dhe klubet sportive të komunës në të cilën gjendet infrastruktura e tillë. Kjo infrastrukturë menaxhohet nga institucioni përkatës arsimor në kuptim të zbatimit të kurrikulës arsimore dhe sportit shkollor ose universitar, mirëpo gjatë kohës kur nuk është në shfrytëzim nga institucionet arsimore ajo menaxhohet në përputhje me aktet nënligjore të komunës përkatëse.
5. Modalitetet, rregullat dhe procedurat për menaxhimin e infrastrukturës sportive të të gjitha niveleve përcaktohen me aktin nënligjor sipas nenit 55 të këtij ligji.

B) Deputeti Bekim Haxhiu – pa përkrahjen e Komisionit funksional

Neni 59.

Të ndryshohet paragrafi 3, si në vijim:

Neni 59

Menaxhimi i infrastrukturës sportive dhe bashkëpunimi ndër komunal

- 3.1. Menaxhimi i infrastrukturës sportive publike mund t'i besohet me kontratë një shoqate apo klubi sportive, një federate sportive, një organizate sportiv, një institucion tregtar dhe një shoqëri tregtare të regjistruar për administrimin e infrastrukturës sportive.
- 3.2. Qeveria e Republikës së Kosovës me vendim mund të shpallë infrastrukturën sportive të caktuara si infrastrukturë sportive të interesit shtetëror.
- 3.3. Qeveria është kompetente të vendos për kritere dhe mënyrën e menaxhimin të infrastrukturës sportive të shpallur interes shtetëror.

Amandamenti 42

Deputeti Bekim Haxhiu – pa përkrahjen e Komisionit funksional

Neni 66.

Të ndryshohet paragrafi 3, si në vijim:

Neni 66 Gjykata e Arbitrazhit Sportiv

3. Vendimet e GjAS janë të formës së prerë dhe obligative ndaj palëve në arbitrazh. Ankesat në CAS nuk shtyjnë ekzekutimin e vendimeve Gjykatës së Arbitrazhit Sportiv.

Amandamenti 43

Neni 67, paragrafi 5, ndryshohet si vijon:

5. Detyrat dhe përgjegjësitë e Gjykatës së Arbitrazhit Sportiv përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e arbitrave dhe ndërmjetësve, procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe kompensimi për punën e tyre përcaktohen me akt nënligjor sipas paragrafit 6 të nenit 65 të këtij ligji.

Amandamenti 44- dy propozime

A) Komisioni funksional

Neni 68, paragrafi 1, ndryshohet si në vijim:

1. Asnjë person me vendim të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale, përveç atyre nga pakujdesia, apo i pezulluar nga Gjykata sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale nuk mund të kryejë punë profesionale në sport, nuk mund të jetë pjesë e organeve drejtuese të organizatave sportive, federatave sportive, klubeve sportive apo federatave ose shoqatave shumësportive, si dhe nuk mund të jetë pjesë e mekanizmave institucionalë të përcaktuara me këtë ligj. I njejtë person nuk do të ketë qasje në ambientet e organizates, nuk do të ketë të drejtë të ndërmarrë detyrë zyrtare dhe do të përmbahet nga kontakti me punonjësit në zyrën/ambientin sportiv. Ky rregull aplikohet edhe në rastet e kandidimit apo përzgjedhjes në funksionet e lartpërmendura.

B) Deputeti Bekim Haxhiu – pa perkrahen e Komisionit funksional

Neni 68.

Të ndryshohet si në vijim:

Neni 68 Papajtueshmëria

1. Përsoni zyrtar në organizatat sportive ndaj të cilit është ngritur aktakuza për vepër penale të dënueshme mbi 6 muaj burg, pezullon menjëherë detyrën.

2. Ka arsye për të besuar se, nëse mbetet në detyrën e tij, personi zyrtar do të asgjësojë, fshehë, ndryshojë ose falsifikojë provat e veprës penale, ose kur rrethanat e posaçme tregojnë se ai do të pengojë rrjedhën e procedurës penale duke ndikuar në dëshmitarë, në të dëmtuarit apo në bashkëpjesëmarrësit.

3. Bazuar në Kodin e Procedurës Penale, Gjykata vendos për masat e pezullimit nga detyra me vendim të arsyetuar.

4. Gjykata përcakton në aktvendim se gjatë pezullimit, personi zyrtar nuk do të ketë qasje në ambientet zyrtare të zyrës së tij, nuk do të ketë të drejtë të ndërmarrë detyrë zyrtare dhe do të përmbahet nga kontakti me punonjësit në zyrën e tij. Aktvendimi i dërgohet të pandehurit dhe mbikëqyrësit të tij të drejtpërdrejtë.

5. Vendimet në lidhje me këtë masë merren sipas kërkesës së prokurorit të shtetit nga gjyqtari i procedurës paraprake para se të ngritet aktakuza dhe nga kryetari i trupit gjykues pasi të jetë ngritur aktakuza.

6. Personi ndaj të cilit është ngritur aktakuzë për vepër penale të dënueshme mbi 6 muaj burg, apo është i dënuar në tri vitet e fundit për vepër penale të dënueshme mbi 6 muaj burg, nuk mund të kandidoj, as të zgjidhet në asnjë pozitë udhëheqëse në shoqatë sportive, klub sportiv, federatë dhe KOK.

Amandamenti 45

Neni 71, paragrafi 3, ndryshohet si në vijim:

3. Procedurat e filluara para hyrjes në fuqi të këtij ligji zbatohen sipas dispozitave të përkatëse të legjislacionit në fuqi kur është iniciuar procedura, me përjashtim të federatave sportive të cilave u skadon afati i licencës, të njëjtave u njihet licenca deri në nxjerrjen e akteve nënligjore përkatëse që nderlidhen me procesin e lejimit të zhvillimit të veprimtarisë sportive.

Amandamenti 46

Neni 72, ndryshohet si në vijim:

Neni 72

Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për Inspektimet

1.Në paragrafin 1 të Shtojcës së Ligjit nr.08/L-067 për Inspektimet, pas nënparagrafit 1.8, shtohet nënparagraf i ri me tekstin në vijim:

1.9. Inspektorati Qendror i Sportit, në kuadër të Ministrisë përgjegjëse për Sport, është përgjegjës për inspektimet në fushën e sportit.

Amandamenti 47

Neni 73, ndryshohet si në vijim:

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Ligji nr. 2003/24, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-075 dhe Ligjin nr. 06/L-115.

Anëtarët e Komisionit me gjashtë (6) vota për asnjë kundër miratuan amendamentet e Grupit punues dhe raporti me 47 amendamente procedohet tek komisionet e përhershme për vlerësim.

5. Shqyrtimi i raportit me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr.05/L-90 për Sponzorizime në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-116.

Ardian Gola tha se Grupi punues ka përfunduar me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr.05/L-90 për Sponzorizime në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-116, mbasi nuk është prezent në këtë mbledhje Eliza Hoxha si kryesuese e Grupit punues propozon që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e radhës me qka u pajtuan anëtarët tjerë të Komisionit.

6.Të ndryshme

Për këtë pikë nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30

E përgatiti

Stafi mbështetës i Komisionit.

Ardian Gola,

Kryetar i Komisionit